

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

DETYRE PROJEKTIMI PER HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve i sistemit të kanalizimeve Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.

VEND NDODHJA: Njësia Administrative Udenisht, fshati Udenisht, Memelisht, Buqezë, Piskupat, Lin.

QELLIMI: Sistem grumbullimi dhe trajtimi te ujrave te përdorura për Mbrojtjen e Liqenit të Ohrit

TE DHENAT KRYESORE:

Hartimi i projektit te objektit “*Ndërtim i sistemit të kanalizimeve i sistemit të kanalizimeve Njësia Administrative Udënisht*”, bazuar ne buxhetin e investimeve per vitin 2022.

Ndërtimi i sistemit te ri te kanalizimeve per rreth 7,600 banore ne fshatrat Udënisht, Mëmëlisht, Piskupat, Buqezë, Lin duhet te kete impakt ne reduktimin e ndotjes se vijes breg Liqenore pasi njësia administrative Udenisht shtrihet e gjitha pergjate kesaj vije.

Vlera e projektimit eshte 14,077,024 leke me tvsh

PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES:


- Fshatrat ne te cilen do te fokusohet ndërtimi i komponentit te kanalizimeve jane pjese e Njësise Administrative Udenisht, nje zone e cila shtrihet ne pjesen perendimore te Liqenit te Ohrid.
- Keto zona jane ne mungese te sistemit te kanalizimeve dhe faktore te drejtperdrejte per ndotjen e ujit te liqenit dhe i gjithe aktiviteti ne zone shkakton edhe demtim te ekosistemit.
- Plotesimi i zonave me sistem kanalizimesh eshte i domosdoshem per te krijuar nje pamje te plote per permbushje te te gjithe parametrave te kerkuara per t’iu pershtatur standarteve. Studimi i kesaj problematike duhet te filloje nga analiza dhe niveli i ndotjes qe shkakton mungesa e rrjetit te kanalizimeve ne liqen dhe mjedis me pas te specifikohen

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Pogradec sh.a)

normat qe do te arrijne me rrjetin e ri per t'iu pershtatur standarteve te cilesise.


- Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Pogradec duke pasur ne fokus komponentin e mbrojtjes mjedisore te Liqenit te Ohrid e shikon si nevojë emergjente ndertimin e nje sistemi kanalizimesh ne keto zona.
- Popullsia:
 - i. Udenisht – 2,800 banore
 - ii. Memelisht – 2,200 banore
 - iii. Buqezë – 380 banore
 - iv. Piskupat – 800 banore
 - v. Lin – 1,400 banore
- Shtrirja gjeografike. (zona e projektit)

Koordinatat gjeografike e zonave te projektit ne Bashkine Pogradec:




Udenisht:

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)















- | | |
|--|---|
|  Fasha Mbrojtëse e Rrugës |  INT.Infrastruktura Transporti |
|  Buffer për Hekurudhën |  N.Take Natyrore |
| Njësitë Strukturore |  V.Varreza |
|  A.Banim | PPV Rrjeti Rrugor i Propozuar |
|  B.Take Bujqesore |  C. Rruge Interurbane Dytesore |
|  BA.Bujqesi + Banim |  E. Rruge Urbane Dytesore |
|  EB.Ekonomi Bujqesore |  F. Rruge Lokale |




INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

Memelisht:



- | | |
|---|---|
|  Fasha Mbrojtëse e Rugës |  S.Sherbime |
|  Buffer për Hekurudhën |  V.Varreza |
| Njësitë Strukturore | |
|  A.Banim |  C. Rruge Interurbane Dytesore |
|  B.Toke Bujqesore |  E. Rruge Urbane Dytesore |
|  INT.Infrastruktura Transporti |  F. Rruge Lokale |
|  N.Toke Natyrore |  Hekurudhe |



Buqeze:

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a

NIPT : M24416601U; Adresa e mail : Info@ukpogradec.al

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)



Piskupat:

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a

NIPT : M24416601U; Adresa e mail : Info@ukpogradec.al

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)




Lin:

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a

NIPT : M24416601U; Adresa e mail : Info@ukpogradec.al

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)



OBJEKTIVI:

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a

NIPT : M24416601U; Adresa e mail : Info@ukpogradec.al

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

Objektivi i detyres se projektimit eshte hartimi i projektit te “*Ndërtim i sistemit të kanalizimeve i sistemit të kanalizimeve Njësia Administrative Udënish*”, sipas planimetrise pergjithshme bashkengjitur kesaj detyre projektimi me synimin :

- i. Te permiresohet cilesia e jeteses se banoreve ne zonat e projektit.
- ii. Te arrihet qendrushmeria e projektit ne aspektin mjedisor, social dhe ekonomik.
- iii. Perdorimi i materialeve të lehta dhe miqësore me mjedisin ne kuader te mbrojtjes se biodiversitetin e ujit të Liqenit të Ohrit.
- iv. Të garantohet largimi dhe trajtimi i ujrave të zeza nga zonat e banuara.
- v. Te garantohet reduktimi i ngarkesave te ujerave te ndotura ne shkarkime duke me metodat miqësore me mjedisin dhe kosto e ulet gjate shfrytezimit dhe mirembajtjes.

QELLIMI I PUNES:

Per realizimin e projektit, projektuesi duhet te rishikoje te gjithe informacionin ekzistues lidhur me projektin qe duhet te hartoje per grumbullimin dhe trajtimin e ujrave te përdorura për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit sipas detyres projektimit dhe te konsultohet me njesine e qeverisjes vendore, sh.a. ujesjellesin, OSSHEE, Telekomin, Autoritetin Rrugor.

Qëllimi per mbrojtjen lidhet me:

- i. Shendetin e njerezve prej cdo efekti negativ apo ndotjeje te ujit qe perdoret per konsum nga njerezit, duke garantuar qe uji te jete i paster dhe i shendetshem.
- ii. Mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi.
- iii. Masat specifike per te parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e ujerave nentokesore ne perputhje me Direktiven 2000/60/EC
- iv. Masat për mbrojtjen e Liqenit te Ohrit

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

- v. Mbrojtja e burimeve kryesore lidhet me mbrojtjen e Liqenit Ohrit, të cilët kanë lidhje të mirëhidraulike ku shpejtësia e lëvizjes së ujit është shumë e madhe.

Duke qenë se rajoni në fjalë sidomos zonat suburbane, kryesisht ndërtimet dhe banesat vendosen në zonat e ngritura për gjate gjithë bregut të liqenit të Ohrit mund të sigurohet trajtimi i ujrave të përdorura me anë të lagunazhit natyror për aq kohë sa sistemet nuk sistemohen në një magjstral pranë. Banesat shtrihen një zone të ulët kodrinore-fushore, ku mund të gjendet një copëz tokë moçalore ose tokë djerr.

Ky ujë vjen në mënyre gravitative, pa kosto energjie në drejtim të këtij sheshi, ku një basen i projektuar sipas një profili vertikal/horizontal me argjila e zhavore, e më pas me ligatina filtruese arrihet të pastrohen ujërat e ngarkuara (të zeza ose të përdorura), me lëndë nitrite, fosfate, duke u kthyer deri në ujra të kategorisë së tretë, të cilat lehtësisht mund të derdhen në përrenj ose liqene ose mund të përdoren për qëllime të tjera.

Në rastin e banesave që bien jashtë skemës gravitative të përgjithshme të fshatit rekomandohen të parashikohen ndërtime të gropave septike ekologjike me sistemin e shqenderzimit, të cilat parashikohen me dhomëza të përbëra dhe të ndërtuara me mure hermetikisht të izoluara, ku uji i ingarkuar me nitrite dhe fosfate mund të transformohet në ujë të pranueshëm për tu derdhur në ujërat sipërfaqësore, por rast pas rasti ka një skemë specifike enkas për të.

Cilesia e studim projektimit duhet të jete e tille qe te arrihet standarti i kerkuar dhe te plotesoje kushtet e projektimit.

TE DHENAT PER PROJEKTIN E KANALIZIMEVE UJERAVE TE NDOTUR:

1. Popullsia aktuale eshte 7,600 banore.
2. Shtesa natyrore e popullsisë te merret 1.0 %.
3. Perspektiva e ujesjellesit te parashikohet per 25 vjet.
4. Norma per fryme te popullates te llogaritet sipas normave ne fuqi.
5. Rilevim i zonës duke evidentuar të gjithë elementët e dallueshëm topografikë, elementët e rrjeteve të propozuara të sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të zeza.

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

6. Materiali i tubacionit te kolektoreve te jete PP/PE/PVC
7. Materiali i pusetave te inspektimit dhe ato te lidhjeve me objektete te jete PP/PE
8. Përshkrim i detajuar i arsyeve që përcaktojnë vëndodhjen e impiantit të trajtimit të ujrave te zeza.

KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI:

Projekti i hartuar duhet te permbaje:

1. Koorografine ne shkalle 1:25 000. (1:10 000).
2. Planimetrine e rrjetit kolektoreve se bashku me skemen teknike te kanalizimeve ne shkalle 1:1000.
3. Profilat gjatesore, kuotat , detaje dhe shenime teknike ne shkalle H 1:1000; V 1:100.
4. Profila terthore dhe detaje dhe shenime teknike ne ne shkallle 1:20.
5. Detaje te ndryshme ne shkalle 1:20.
6. Projektin e strukturave para-trajtimit dhe ujembajtese me shkalle agresioni si vaska e dekantimit, e tharjes per trajtimin e ujrave te perdorur ne shkalle 1:100.
7. Harta pronesise dhe miratimi i pikes se shkarkimit mbas trajtimit ne shkalle 1:1000.
8. Te paraqiten hartat me azhornimet e rrjeteve inxhinierike ekzistuese ne shkalle 1:1000.
9. Te paraqitet ndarja ne zona e investimit te ndertimit.
10. Relacionin teknik per zgjidhjen e dhene sipas detyres se projektimit.
11. Llogaritjet hidraulike.
12. Llogaritjet konstruktive.
13. Analiza krahasimore mjedisore, sociale dhe tekniko-ekonomike.
14. Pershkrimi i gjendjes se trasese sipas studimit Gjeologo-inxhinierik.
15. Relacioni i Topografise dhe pikat e forta te projektit.
11. Preventivi i kryerjes se punimeve, duke u mbeshtetur ne çmimet mesatarete rajonit te shoqeruar me analizat perkatese.
12. Metodologjia e pergatitjes se zerave te punes ne preventiv.
13. Specifikimet teknike te pergjithshme dhe ato veçanta te zbatimit te projektit.
14. Projekt preventivi te paraqitet ne tre kopje dhe ne forme dixhitale se bashku me analizat teknike te kostove.
15. Grafikon e punimeve, të detajuar sipas zërave të punës, si dhe kohëzgjatja

INVESTITORI (Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a)

e punimeve dhe periudhës së garancisë së punimeve.

HARTOI

Zyra e Deges Teknike

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a

Grupi i Hartimit: